



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2019/ 11 prot.

Datë 29/08/2024

V E N D I M
Nr. 1136/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29/08/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1095/2024, datë 19.08.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05116-05-16-2024, me objekt: “Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”, me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK, me NIPT: J61817047D dhe me adresë: *Bulevardi “Zhan D’ark”, Ndërtesa 32, Hyrja 16, Kati II, Ap.1, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “ATOM” SHPK me NIPT: L22203042N dhe me adresë: *Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga “Islam Alla”, Pallati Nr.56, Kati i 1, Tiranë.*

Operatori ekonomik “C.C.S” SHPK me NIPT: J61901033C dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Sulejman Delvina”, nr.8, kodi postar nr.1019, Tiranë.*

Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK me NIPT: L81506043D dhe me adresë: *Rruga “Ali Demi” përballë “Fushës së Zezë”, zona kadastrale 8150, numri i pasurisë 8/801-B1, Tiranë.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 19.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1095/2024, datë 19.08.2024, ku vendosi:

[...]

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “BNT ELECTRONICS” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05116-05-16-2024, me objekt: “Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”, me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05116-05-16-2024, me objekt: “Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”, me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 17039/1 prot., datë 23.08.2024, protokolluar me tonën nr. 2019/8 prot., datë 2408.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1095/2024, datë 19.08.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke i rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-05116-05-16-2024, me objekt: “*Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)*”, me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 17039/1 prot., datë 23.08.2024, protokolluar me tonën nr. 2019/8 prot., datë 2408.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1095/2024, datë 19.08.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke i rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-05116-05-16-2024, me objekt: “*Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)*”, me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” Sh.P.K në procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1095/2024, datë 19.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-05116-05-16-2024, me objekt: “*Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)*”, me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

